

PROCEDURA DHE RREGULLAT PER RREGJISTRIMIN E STUDENTEVE NE SEZONIN E DIPLOMIMIT VJESHTE 2017-2018

Sezoni DIPLOMIMIT Vjeshte 2017-2018 per programet "Bachelor", "Master Profesional" dhe "Master i Shkencave" te percaktuara sipas cdo fakulteti do te kryhet ne periudhen 26/09/2018 deri 28/09/2018 dhe do te kete date diplomimi 28/09/2018.

Per sezonin e diplomimit rregjistrimi i studenteve do te kryhet online nga vete studentet nga data 26/09/2018 deri 27/09/2018.

- Pas kesaj date asnje student nuk mund te kryeje veprime per rregjistrime ne provimet e ketij sezoni.
- Procedura dhe menyra e rregjistrimit do te afishohen ne monitoret e cdo fakulteti dhe ne websitin e universitetit ne linkun "SHËRBIMET ONLINE" → "Sezonet e provimeve"
- Ne provimet e sezonit te diplomes nuk do te lejohen studentet qe nuk kane shlyer detyrimin e pageses se tarifes se shkollimit.
- Kujtojmë se per tu rregjistruar ne sezonin e diplomimit, te gjithë studentet duhet te jene te pasjitur me te dhenat personale qe ata kane vendosur gjate procedures se rregjistrimit te tyre prane fakultetit ku ata studiojne. N.q.s studentet hasin veshtiresi me keto te dhena atehere duhet te komunikojne me sekretarite e departamenteve te fakultetit perkates per tu njohur me to.
- Pedagoget dhe sekretarite mesimore duhet te kene ngarkuar ne sistem te gjitha procesverbalet e provimeve qe u perkasin ketyre programeve deri me daten 25/09/2018, perndryshe, asnje student nuk do te mund te rregjistrohet ne provimin e diplomimit.
- Studenti ne librezën e tij duhet te kete te gjitha lendet te vleresuara me note kaluese (me perjashtim te provimit te temes se diplomes).

Cilet studente kane te drejte te rregjistrohen ne sezonin e diplomes?

1. Studenti duhet te jete DIPLOMANT – pra kontrollohet qe kursi i studentit te jete i barabarte me vitin e fundit te kohezgjatjes se programit. Mesazhi qe i shfaqet studentit eshte "Ju nuk jeni ne kursin e fundit. Ky sezon i dedikohet vetëm studentëve që janë për t'u diplomuar"

Per shkak te kushteve te vendosura nga sistemi lidhur me kete sezon, ata qe nuk plotesojne kriteret nuk do te mund te prenotohen dot. Per kete arsye studenti duhet te verifikoje ne fillim nese ka lende te pafrekuentuara, apo qe nuk i ka kaluese, para se te rregjistrohet ne sezonin e diplomimit.